

**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 21.1.2015**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 883, DATË 13.5.2009,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR  
REGJISTRIMIN E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 25, 28, 33, 41, 44, 46, 76, 77, 79, 80, 82, 87, shkronjat “a”-“gj”, 109, 137, 149, 172, 181, 194, 198 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 11, të vendimit, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për të përcaktuar drejtimet dhe kriteret e përdorimit të të ardhurave që i lihen DPPM-së.”.

2. Në lidhjen nr. 1, “Tarifat për patentat e shpikjeve”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1.5, fjalët “Tarifë për publikimin e Patentës Evropiane dhe të amendamenteve në patentë” zëvendësohen me “Tarifë për publikimin e shtrirjes së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë.”.

b) Në pikën 1.8, fjalët “Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni” zëvendësohen me “Tarifë për shqyrtim të mëtejshëm”, ndërsa vlera “2 000” zëvendësohet me vlerën “7 000”.

c) Pika 1.18 shfuqizohet.

ç) Në pikën 1.19, vlera “500” zëvendësohet me vlerën “1 500” .

d) Në pikën 1.20, vlera “500” zëvendësohet me vlerën “2 000” .

dh) Në pikën 1.44, vlera “3 000” zëvendësohet me vlerën “9 000”.

Pas pikës 1.44 shtohen: pika 1.45, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për kërkesë për ndryshimin ose shtimin e prioritetit” dhe vlerë “7 000 ALL”; pika 1.46, me emërtimin e tarifës: “Tarifën shtesë për zgjatje afati” dhe vlerë “7 000 ALL” dhe pika 1.47, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për publikimin e vlefshmërisë së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë” dhe vlerë “10 000 ALL”.

ë) Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.24-1.43) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar, në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

\* Tarifat me nr. rendor 1.1; 1.4; 1.6; 1.7; 1.8; 1.9; 1.11; 1.12; 1.13 të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa të jenë 100 (njëqind) lekë.”.

3. Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 2, “Tabela e tarifave të shërbimit për certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e certifikatave të mbrojtjes shtesë (nr. rendor 2.2-2.6) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2

(dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

\* Tarifa e aplikimit me nr. rendor 2.1 të reduktohet në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës.”.

4. Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 3, “Tabela e tarifave të shërbimit për modelet e përdorimit”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit me numër rendor (3.23-3.32) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

\* Tarifat me nr. rendor 3.1- 3.12 të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i modelit të përdorimit është njëkohësisht edhe shpikësi i modelit të përdorimit. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa të jenë 100 (njëqind) lekë.”.

5. Në lidhjen nr. 6, “Tabela e tarifave të shërbimit për treguesit gjeografikë”, pas pikës 6.13 shtohet pika 6.14, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për ripërtëritje të treguesit gjeografik” dhe vlerë “8 000 ALL”.

6. Kudo në tekstin e lidhjes nr. 7, “Tabela e tarifave për shërbimet lidhur me topografitë e qarqeve të integruara”, fjalët “Topografitë e qarqeve të integruara” zëvendësohen me “Topografitë e produkteve gjysëmpërçuese” .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**